



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 5622 prot.

Tiranë, më 30.1. 2019

Lënda: Përcjellje e projektplanit vjetor për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021

**Z. GENC GJONÇAJ**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KUVENDIT TË SHOIPËRISË**

Tiranë

I nderuar z. Gjonçaj,

Në vijim të paraqitjes së shkresës “Dërgohet projektplani vjetor për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021” dërguar nga INSTAT-i, me nr.1788 prot, datë 4.12.2018, drejtuar Kryeministrit dhe për dijeni Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, përcjellim për procedim të mëtejshëm për paraqitjen e projektplanit vjetor 2019, për miratim në Kuvend.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Qui. Mimos. Pano  
Pet. Votum,  
— 9 —

31.1.2018

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

# Engjell AGACI

Engjell AGACI



5622  
4 12 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

KOORDINIMI I SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR

Nr. 1788 Prot.

Tiranë, më 04.12. 2018

**Lënda:** Dërgohet Projekt-Plani Vjetor 2019 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021

**Drejtuar:** SH.T.Z. Edi Rama  
Kryeministër

**Për dijeni:** SH.T.Z. Gramoz Ruçi  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Tiranë

I nderuar Z. Kryeministër,

Mbështetur në nenin 9, pika 4 të Ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", ju dërgojmë bashkëngjitur projektplanin vjetor 2019 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017. Plani vjetor shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore që duhet të kryhen gjatë vitit 2019 dhe përcakton kryesisht institucionet prodhuese të statistikave zyrtare, institucionet publike të detyruara të japin të dhënat administrative që disponojnë dhe afatet e kryerjes së aktiviteteve.

Projektdokumenti është përgatitur pas një procesi konsultimesh me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën cilësinë e prodhuesve të statistikave zyrtare, duke u bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Programi i Statistikave Zyrtare për vitin 2019. Në mbështetje të nenit 20, shkronja a), të ligjit të statistikave zyrtare, projektdokumenti është shqyrtuar gjithashtu nga Bordi drejtues.

Në mbështetje të nenit 9, pika 5, të ligjit të statistikave zyrtare, lutemi paraqitjen e Projektplanit vjetor 2019 pranë Kuvendit të Shqipërisë për miratim.

Bashkëngjitur shkresës ndodhen:

1. Projektplanin Vjetor 2019
2. Relacioni shpjegues
3. Materiali i lartpërmendur në forme elektronike,

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DELINA IBRAHIMAJ**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rruga "Vllazen Huta", Nd. 35, Njesia Administrative Nr. 2, Tirana, ALBANIA,  
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

